



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UJESJELLES KANALIZIME LIBRAZHD

Nr. _____ Prot

Librazhd, me 05.07.2019

Shtojca 13

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: NAZERI - 2000 sh.p.k., me adrese; Rruga e Kavajes, Qendra Condor, Kati II, Tirane, me NIPT K31422029Q

Procedura e prokurimit: **“Sherbimi i ruajtjes se objekteve me roje private”**

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-06170-02-04-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *Fondi limit 20,015,540* (njetzet milion e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet) lekë pa TVSH ; Fondi planifikuar për vitin e parë 12 muaj me 10,007,270 leke pa tvsh; dhe për vitin e dytë me 10,007,270 leke pa tvsh; Kontrata do të lidhet për çdo vit sipas fondit të miratuar. Vene në dispozicion nga të ardhurat e institucionit.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Kane marrë pjesë në procedurën e prokurimit :

1. Operatori ekonomik “UEVI -2015 ” shpk me nr.Nipti L52904201S me oferte 18,871,687.20 leke pa tvsh
2. Operatori ekonomik “Eurogjici-Security” shpk, me nr.Nipti K31929010K me oferte 19,836,259.89 leke pa tvsh
3. Operatori ekonomik “Bahiti -G” shpk , me nr.Nipti K83410201O me oferte 19,836,259.90 leke pa tvsh
4. Operatori ekonomik “Kumria I” shpk me nr.Nipti K32712210C ,me oferte 19,836,259.90 leke pa tvsh
5. Operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk, me nr.Nipti K31422029Q me oferte 19,836,259.90 leke pa tvsh

(me numra dhe fjalë)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Te skualifikoje oferten e operatorit ekonomik “Eurogjici-Security” sh.p.k sepse Operatori nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithë kerkesave per kualifikim sic kerkohen ne shtojcat e DT.

Operatori ekonomik “Eurogjici-Security” shpk.

2.1.Lidhur me plotesimin e kerkeses, kriteret e vecanta te kualifikimit, Kapaciteti ligjor/profesional pika 2.1.3 nga Autoriteti Kontraktor është përcaktuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë: *“Çertifikatë për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave sipas Ligjit 75/2014 të lëshuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan për të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) punonjes”,* si dhe ne pikën 2.3.3 është përcaktuar: *“Operatori ofertues duhet të paraqesë Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF (Elbasan) si dhe vërtetim përformance nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan jo më vonë se 1 (nje) muaj nga hapja e ofertave, në të cilën të pasqyrohet informacioni për: -Lista emërore e punonjësve të çertifikuar konform Ligjit 75/2014 nënkategoria 1.3.A për jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës”,* Per kete, ne Ligjin Nr.75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", Në nenin.9,"Llojet i certifikatave" *“Çertifikatat per titullarin e SHPSF-se, per drejtuesin teknik dhe per punonjesin e shërbimit ndahen ne lloje, sipas nenkategorise se licences” ; a) nënkategoria 1.3.A dhe b) nenkategoria 1.3.B; Ne nenin 5 "Çertifikimi”, pika 2 përcaktohet se; "Çertifikimi i punonjësit të shërbimit është kompetence e drejtorit të policisë së qarkut.", Ndërsa pika.5 e këtij neni përcakton se: *Çertifikata është e vlefshme për 4 vjet me të drejtë ripërtëritje, Titullarin e Subjektit, Drejtuesin Teknik dhe punonjësing e shërbimit,"dhe Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, afati i vlefshmërisë së certifikatave të punonjësve të shërbimit, shpsf, është 4 vjeçar nga momenti i certifikimit të tyre”.**

Referuar dispozitave dhe kriterëve të sipër cituara, që oferta e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk të konsiderohet e vlefshme duhej: -T’i provohej autoritetit kontraktor se ka të licensuar (çertifikuar) pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, te pakten 15 punonjës shërbimi, nepermjet paraqitjes vertetimit me liste emrore te punonjesve nenkategoria 1.3.A, si dhe duke paraqitur çertifikatat për punonjës shërbimi lëshuar nga Drejtoria Vendore; - Çertifikatat për punonjës shërbimi lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë, Elbasan, për të paktën 15 punonjës shërbimi të paraqitur nga ky operator si pjesë e ofertës, që të konsiderohet e vlefshme, sipas përcaktimeve të dispozitave të sipër cituara, duhet të jenë të lëshuara brenda **afatit 4 vjeçar, pra të jenë lëshuar jo më parë se data 07.03.2015;**

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin e prokurimit elektronik (SPE), te shoqerise “Eurogjici Security” shpk, rezulton se ka paraqitur vertetim performance leshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan nënkategoria 1.3.A dhe 1.3.B me nr.1727 date 05.03.2019, ku percaktohet se ka qender kontrolli te miratuar nga DVP Elbasan me nr.5386 prot date 31.07.2018 si dhe jepet informacioni per burimet njerzore, per 16 punonjes me liste emrore ku percaktohet numri dhe data e certifikimit per çdo punonjes. Gjithashtu ne funksion te

vertetimit te performances policise operatori “Eurogjici Security” shpk, ka ngarkuar ne sistemin e prokurimit elektronik 16 çertifikata te punonjesve, nga te cilat te cilet vetem 12 çertifikata jane konform Ligjit 75/2014 me afate 4-vjeçar nga data e lëshimit dhe akoma me tej 2 çertifikata nuk korrespondojne me vertetimin e Policise (D.Kllogjeri, K.Gjeka). Pra nga 15 çertifikata te punonjësve sipas vendsherbimeve qe kerkohen konform ligjit 75/2014 me afate 4-vjeçar nga data e lëshimit, ka paraqitur vetem 12 çertifikata te punonjesve dhe qe konfirmohen 10 çertifikata te vlefshme me listen emrore te performances se Drejtorise Vendore te Policise.

Ky operator nuk ka paraqitur çertifikatat e punonjësve të shërbimit brenda afatit 4-vjeçar të vlefshmërisë per numrin e kerkuar ne dokumentat e tenderit, për rrjedhojë nuk plotësonë kriterin e sipër cituar;

2.2.Lidhur me paraqitjen e ofertës Autoriteti Kontraktor në shtojca 1, Formulari i Ofertës Ekonomike ka përcaktuar tabën me rubrikat përkatëse për tu plotësuar nga operatorët ekonomik ku janë përcaktuar shërbimet për periudhën 24 muaj, për 1 vendroje me 4.98 roje dhe për 3 vendroje me 3.32 roje dhe konkretisht tabela me rubikat përkatëse është përcaktuar si vijonë:

1	2	3	4	5	6	7
N r	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vendro jeve)	Numri total i rojeve për vendroje	Çmimi Njësi /muaj	Oferta në total (neto)
1	Sherbimi i Ruajtjes dhe i Sigurise me roje fizike me tre turne 24 ore shtojca 11	24	1	4.98		
2	Sherbimi i Ruajtjes dhe i Sigurise me roje fizike me dy turne 16 ore shtojca 11	24	3	3.32		
	Oferta Neto ne total (X)					
	TVSH (%) (X)					
	Oferta total (X)					

Në DST Udhëzime për operatorët ekonomik Seksioni i I, **pika 1.1 është përcaktuar:**
“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”, dhe në pikën 1.5 **Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

a) Formulari i Ofertës, plotësuar sipas **Shtojcës 1 të DT.**

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të*

gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”

Operatori ekonomik “Eurogjici Security” shpk, nuk ka plotësuar dhe dorëzuar formularin e ofertës të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe konkretisht në Shtojcën 8 “Kriteret e veçanta për kualifikim”, Pika 2.3.7 ka përcaktuar se: “*Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **analizën e kostos për ofertën e paraqitur**. (Shih **Shtojca 1 - Sqarime**)*”, nuk ka plotësuar Formularin e Ofertës Ekonomike, tabelen perkatese sipas **Shtojcës 1 të DT** të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në rubrikat përkatëse.

Sa më sipër, Autoriteti kontraktor gjykon se operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të nenit 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, të ndryshuar, çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumenteve të tenderit do të refuzohet.

2.3.Lidhur me kërkesat për kualifikim të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në DST shtojca 8, pikën 2, kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik pika 2.3.2 është përcaktuar: “*Autorizim individual nga AKEP për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi dhe alarmi, konform Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Per komunikimin elektronike në RSh” me zonë mbulimi vendi ku do të kryhet shërbimi*”, Përkatesisht; referuar shtojcës 11 shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit Shpërndarja: - **Sipas vendndodhjes së objekteve: Depo e Ujit Qarrishte, Librazhd, Prrënjës dhe Qaf Thane**. Që oferta e këtij operatori të konsiderohet e vlefshme duhet t’i provonte autoritetit kontraktor se zoteron Autorizim Individual për përdorim të frekuencave për radiokomunikim dhe alarm me zonë mbulimi vendi i kryerjes së shërbimit si më sipërcituar. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “Eurogjici Security” shpk, rezultoi se ka paraqitur Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave për radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP me zonë mbulimi qarku (**Elbasan, Peqin, Cerrik, Belsh, Gramsh, Librazhd**)-45 km. Kjo shoqëri nuk mbulon me frekuencë për radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP për vendin e kryerjes së shërbimit **Depo Ujit pishëm Qaf Thane**, duke mos përmbushur kriterin kualifikues.

2.4.Lidhur me plotësimin e kërkesës, kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2.3.3, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar: “*Operatori ofertues duhet të paraqesë vërtetim përformance nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan jo më vonë se një muaj nga hapja e ofertave, në të cilën të pasqyrohet informacioni për: -Lista emërore e punonjësve të certifikuar konform Ligjit 75/2014 nënkategoria 1.3.A për jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës; -Të ketë qendër kontrolli me grup të gatshëm për parandalimin e ngjarjeve të mundëshme; ...*, kërkon nga operatorët ekonomik të cilët ushtrojnë aktivitet për shërbimin privat të sigurisë fizike nënkategoria 1.3.A, që si pjesë e ofertes të paraqesin vërtetim përformance nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan ku të përcaktohet se operatorët ekonomik ka grup të gatshëm për parandalimin e ngjarjeve të mundëshme. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator dhe konkretisht të vërtetimit të performancës lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan me Nr.1727 datë 05.03.2019 rezultoi se në përberje të grupit është **1(një) punonjës** kur në UM Brendshëm nr.130 datë 05.03.2018 grupi i gatshëm përbehet jo më pak se **2 (dy) punonjës për çdo turn**. Ky operator nuk ka mundur të plotësojë grup të gatshëm sipas kërkesës

autoritetit kontraktor të përcaktuara në TD;

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

Sqarojmë se, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Sa me lart oferta e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk refuzohet.

2. Te skualifikoje oferten e operatorit ekonomik ““Bahiti-G”” sh.p.k sepse Operatori nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithë kerkesave per kualifikim sic kerkohen ne shtojcat e DT.

2.1.Lidhur me kërkesat për kualifikim të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në DST shtojca 8, pikën 2, kriteret e vecanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik pika 2.3.2 është përcaktuar: *“Autorizim individual nga AKEP për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi dhe alarmi, konform Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimin elektronik në RSh” me zonë mbulimi vendi ku do të kryhet shërbimi”,* Perkatesisht; referuar shtojces 11 shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit *Shpërndarja: - Sipas vendndodhjes së objekteve: **Depo e Ujit Qarrishte, Librazhd, Prrenjas dhe Qaf Thane.***

Që oferta e këtij operatori të konsiderohet e vlefshme duhej t’i provonte autoritetit kontraktor se zoteron Autorizim Individual për përdorim të frekuencave për radiokomunikim dhe alarm me zonë mbulimi vendi i kryerjes së shërbimit si më sipërcituar. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “Bahti-G” shpk, rezulton se ka paraqitur Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave për radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP me zonë mbulimi **(Elbasan, Librazhd, Cerrik, Peqin, Gramsh)- 35 km.** Kjo shoqëri nuk mbulon me frekuencë për radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP për vendin e kryerjes së shërbimit **Depo Ujit pishëm Qaf Thanë**, duke mos përmbushur kriterin kualifikues.

2.2.Lidhur me plotësimin e kërkesës, kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2.3.3, Autoriteti Kontraktor në kriteret e vecanta për kualifikim ka përcaktuar: *“Operatori ofertues duhet të paraqesë vërtetim përformance nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan jo më*

vonë se nje muaj nga hapja e ofertave, në të cilën të pasqyrohet informacioni për: -Lista emërore e punonjësve të certifikuar konform Ligjit 75/2014 nënkategoria 1.3.A për jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës; -Të ketë qendër kontrolli me grup të gatshëm për parandalimin e ngjarjeve të mundshme; -Të ketë 1(një) përgjegjës shërbimi; -Të mos ketë masë administrative për operatorin ekonomik (subjektin) dhe drejtuesin teknik sipas percaktimeve të nenëve 44, 45 të Ligjit.75/2014. Nuk ka ngjarje të ndodhura në objektet ku kryhet shërbim”, kërkon nga operatorët ekonomik të cilet ushtrojnë aktivitet për shërbimin privat të sigurojë fizike nënkategoria 1.3.A, që si pjesë e ofertes të paraqesin vërtetim përformance nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, ku të mos ketë ngjarje të ndodhura në objektet ku kryhet shërbim, Nga verifikimi dokumentacionit të paraqitur nga ky operator dhe konkretisht të vërtetimit të performancës lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan me Nr.1112 datë 11.02.2019 rezulton se në pjesën e IV të modularit të performancës ngjarje të ndodhura: **a. Ngjarje 2 (dy) ngjarje në vitin 2018**, duke mos plotësuar kërkesën autoritetit kontraktor të përcaktuara në TD;

2.3.Lidhur me plotësimin e kërkesës, kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2.3.5, Autoriteti Kontraktor në kriteret e vecanta për kualifikim ka përcaktuar: “*Operatori ekonomik të disponojë: Jo më pak se 4 (katër) armë brezi (një në çdo vendshërbim), të vërtetuara me dokumenta pronësie (autorizim nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, kontratë shitjeje, faturë tatimore shitje)*, kërkon nga operatorët ekonomik të cilet ushtrojnë aktivitet për shërbimin privat të sigurojë fizike nënkategoria 1.3.A, që si pjesë e ofertës të vërtetojë me dokumenta se ka në pronësi jo më pak se 4 (katër) armë brezi. Nga verifikimi dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit nga ky operator dhe konkretisht të dokumentacionit blerje arme, rezulton se ka në pronësi 3 (tre) arme brezi të vërtetuara me dokumentacionin perkates, duke mos plotësuar kërkesën autoritetit kontraktor të përcaktuara në TD;

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”

Sqarojmë se, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Sa me lart oferta e operatorit ekonomik “Bahiti-G” shpk refuzohet.

3. Të skualifikoje ofertën e operatorit ekonomik “UEVI-2015” sh.p.k sepse Operatori nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plote dhe të sakte për të deshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim sic kerkohen në shtojcat e DT.

3.1.Lidhur me kërkesat për kualifikim të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në DST shtojca 8, pikën 2, kriteret e vecanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik pika 2.3.2 është përcaktuar: *“Autorizim individual nga AKEP për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi dhe alarmi, konform Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Per komunikimin elektronike në RSh” me zonë mbulimi vendi ku do të kryhet shërbimi”,* Përkatesisht; referuar shtojces 11 shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit *Shpërndarja: - Sipas vendndodhjes së objekteve: **Depo e Ujit Qarrishte, Librazhd, Prrenjas dhe Qaf Thane.***

Që oferta e këtij operatori të konsiderohet e vlefshme duhej t’i provonte autoritetit kontraktor se zoteron Autorizim Individual për përdorim të frekuencave për radiokomunikim dhe alarm me zonë mbulimi vendi i kryerjes së shërbimit si më sipërcituar. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “UEVI-2015” shpk, rezulton se ka paraqitur Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave për radiokomunikim të lëshuar nga AKEP me zonë mbulimi Elbasan **-45 km.** Kjo shoqëri nuk mbulon me frekuencë për ***radiokomunikim dhe alarm*** të lëshuar nga AKEP për vendin e kryerjes së shërbimit **Depo Ujit pishëm Qaf Thanë,** duke mos përmbushur kriterin kualifikues.

3.2.Lidhur me plotësimin e kërkesës, kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2.3.3, Autoriteti Kontraktor në kriteret e vecanta për kualifikim ka përcaktuar: *“Operatori ofertues duhet të paraqesë vërtetim përformance nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan jo më vonë se një muaj nga hapja e ofertave, në të cilën të pasqyrohet informacioni për: -Lista emërore e punonjësve të çertifikuar konform Ligjit 75/2014 nënkategoria 1.3.A për jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës; -Të ketë qendër kontrolli me grup të gatshëm për parandalimin e ngjarjeve të mundshme; -Të ketë 1(një) përgjegjës shërbimi; -Të mos ketë masë administrative për operatorin ekonomik (subjektin) dhe drejtuesin teknik sipas përcaktimeve të nenëve 44, 45 të Ligjit.75/2014. Nuk ka ngjarje të ndodhura në objektet ku kryhet shërbim”,* kërkon nga operatorët ekonomik të cilet ushtrojnë aktivitet për shërbimin privat të sigurojë fizike nënkategoria 1.3.A, që si pjesë e ofertes të paraqesin vërtetim përformance nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, ku të mos ketë masë administrative të dhëna nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan për ushtrim aktiviteti. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator dhe konkretisht të vërtetimit të performancës lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan me Nr.1181 datë 13.02.2019 rezulton se në pjesën e III të modularit të performancës ***Masa administrative të dhëna nga DVP gjithsej 1,*** duke mos plotësuar kërkesën autoritetit kontraktor të përcaktuara në TD;

3.3.Lidhur me paraqitjen e ofertes ekonomike Autoriteti Kontraktor në shtojca 1, tabela dhe sqarime 1,2 për operatorët ekonomik është kërkuar:

-Bashkelidhur formularit të çmimit të ofertes të paraqitet preventivi për një roje dhe 1 vend-roje **me 3 turne (4.98 roje) në muaj,** sipas tabelës së mëposhtme;

- Bashkelidhur formularit të çmimit të ofertes të paraqitet preventivi për një roje dhe 1 vend-roje **me 2 turne (3.32 roje) në muaj,** sipas tabelës së mëposhtme;

Dhe në shtojca 8, Kërkesat e vecanta të kualifikimit pika 2.3.7 ka përcaktuar: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizen e kostos për ofertën e paraqitur. (Shih Shtojca 1 - Sqarime)

Pra Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit, ju ka kërkuar të gjithë ofertuesve që

të paraqesin ofertën e tyre ekonomike bazuar në analizën e kostos mujore, për një roje dhe një vendroje me tre turne (4.98 roje) në muaj me shërbim 24 ore, dhe për një roje dhe një vendroje me dy turne (3.32 roje) në muaj, si dhe gjatë këtyre përlogaritjeve të merren parasysh të gjitha parashikimet ligjore në lidhje me pagën bazë minimale ligjore, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë; si dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16.7%.

Nga verifikimi i ofertes/analizes së kostos të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga shoqëria “UEVI -2015” shpk, rezulton se nuk ka respektuar kërkesën e AK në lidhje me paraqitjen e preventivave ***per një roje dhe 1 vend-roje në muaj, sipas tabelave perkatese***, duke paraqitur ofertën me përlogaritje analize kostoje ditore dhe me të dhëna kontradiktore, si dhe në formularin e ofertes nuk është paraqitur ***çmimi total i ofertes me dhe pa tvsh***. Oferta e paraqitur bazuar në analizën e kostos ditore për vendshërbimet e kërkuara nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, gjë e cila e bën ofertën të pavlefshme.

Autoriteti kontraktor gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit të kërkuar nga AK-ja.

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

Sqarojmë se, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Sa më lart oferta e operatorit ekonomik “UEVI -2015” shpk refuzohet.

Përsa me sipër duke qenë se kemi dy operatore ekonomikë Kumria-1 shpk dhe Nazeri-2000 shpk me të njëjtën ofertë në vlerë ekonomike të njëjta, në respekt të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66, pika 8, autoriteti kontraktor në datë 13.06.2019 zhvilloi procedurën për hedhjen e shortit. Në përfundim të procedurës rezultoi se fitues doli operatori ekonomik **“Nazeri - 2000 shpk”**, **Tirane**, i cili u shpall dhe fitues i këtij

shorti. Te dy operatoret ekonomike ishin dakort me proceduren e ndjekur nga ana jone dhe nuk paten asnje verejtje mbi shortin e zhvilluar duke pranuar rezultatin final ku operatori ekonomik **“Nazeri - 2000 shpk”, Tirane** u shpall fitues i ketij shorti.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [**NAZERI - 2000 sh.p.k., me adrese; Rruga e Kavajes, Qendra Condor, Kati II, Tirane, me NIPT K31422029Q/** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *“Nazeri 2000”* shpk, me oferte 19,836,259.90 (nentembdhjete milion e teteqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e pesedhjetë nente pike nentedhjetë) leke pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **SHA, UJESJELLES KANALIZIME LIBRAZHD PRRENJAS** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10 ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do te veprohet ne zbatim te ligjit siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19.03.2019

Ankesa: PO

Kthyer pergjigje :

- Operatorit ekonomik “EUROGJICI” shpk i eshte kthyer pergjigje me shkresen nr.53/1, date 27.03.2019 .
- Operatorit ekonomik “NAZERI 2000 ” shpk i eshte kthyer pergjigje nr.55/1, date 27.03.2019 .
- Operatorit ekonomik “BAHITI-G” shpk i eshte kthyer pergjigje nr.54/1, date 27.03.2019.

Ne zbatim te vendimit te KPP eshte kryer rivleresimi ne SPE ne date 22.05.2019. Pas kryerjes se rivleresimit nuk ka pasur ankesa per rivleresimin dhe hedhjen e shortit.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

AGRON GEGA